- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

Dokumenta Standarde të Tenderit

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP².

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

² Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Dokumenta Standarde të Tenderit

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori
Adresa/Tel.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS³

³ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të

Dokumenta Standarde të Tenderit

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- e Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- f. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional:

2.1.a Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata te vlefshme, si me poshte:

- Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001** ose ekuivalente të saj. Çertifikata e vlefshme në ditën e hapjes së ofertave dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të mjedisit, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 14001** ose ekuivalente të saj. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në ditën e hapjes së ofertave dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar **OHSAS 18001** ose **ISO 45001** ose ekuivalente të saj. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në ditën e hapjes së ofertave dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatë **ISO 1452-1:2009** “Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nën presion” ose ekuivalente të saj. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në ditën e hapjes së ofertave dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes

2.1.b Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale të vlefshme të shoqërisë për Zbatim, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

- NP 3-A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- NP 12-A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS 2-A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS 4-A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS 12-A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- NS 14-A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS 19-A Sistemet kundër zhurmës për infrastruktura.

2.1.c Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencat:

- Licensë e lëshuar nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur (ne pronesi ose kontrate shërbimi) me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme Kodi III.1.A
- Operatori ekonomik të kete Liçense profesionale nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi 1.2.A., për Mbrojtjen nga Zjarri.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.a Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2017, 2018, 2019**) të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatesë dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

2.2.b Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2017, 2018 dhe 2019**) ku vlera mesatare e tyre nuk duhet të jetë më e vogël se **50% i vleres së fondit limit** të kontrates që prokurohet.

2.2.c Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një document që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2019 dhe 2020.**

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1/a Dëshmi nga operatori ekonomik për Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;

OSE

2.3.1/b Dëshmi nga operatori ekonomik për Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a *Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **formularët e vlerësimit sipas shtojcës perkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratat e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, Faturat, aktet e kolaudimit.** Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

2.3.1.b *Në rastin e parvojes së ngjashme në sektorin privat kërkohej si dëshmi **formularët e vlerësimit sipas shtojcës perkatëse të DST të shoqëruar me kontratë e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, faturat, akt kolaudimi të objektit.***

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës për periudhën **Janar 2020— Shtator 2020** ku të kete jo më pak se **55 (pesëdhjetë e pese) punonjës, me kohe të plote pune**, përfshirë drejtuesit ligjor, teknik dhe stafin menaxherial. Për kete duhet të paraqesi:

- Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen e kerkuar **Janar 2020— Shtator**.
- Listepagesat (formulet E-sig 025/a per keto periudha) te plotesuara rregullisht dhe te konfirmuara nga dega e tatimeve ku ofertuesi eshte regjistruar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën individuale të punës të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhen Janar 2020 - Shtator 2020, stafin inxhinierik si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) Inxhinier Elektrik me certifikim AUDITUES ENERGJIE

1 (nje) Inxhinier Mjedisi (me certifikate Auditimi Mjedisor/ekspert mjedisor, certifikuar per demet ne mjedis)

2.3.4 Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (nje) mjek. Per te verteutar kete kriter duhet te paraqitet kontratë individuale të punës të vlefshme, license profesionale (urdher mjeku) dhe diploma perkatese. Mjeku duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise për periudhen Janar 2020 - Shtator 2020.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate të lëshuar nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili do te jete pergjegjes per ndjekjen e punimeve objekt prokurimi, si dhe te figuroje në licensën e shoqërisë. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se Drejtuesi Teknik do te jetë i pranishem gjatë gjithë kohës që punimet do të kryhen në objekt.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij 2 (dy) specialiste te certifikuar per "Punime ne lartesi", te leshuara nga nje organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues), te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2020 – Shtator 2020. Per keto specialiste duhet te paraqitet nga operatori ekonomik kontratë individuale të punës të vlefshme dhe certifikata perkatese.

2.3.7 Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2020 – Shtator 2020. Detyrimisht te paraqitet kontrate individuale të punës të vlefshme dhe certifikata perkatese.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje person te shoqerise qe te disponoje deshmi trajnimi si "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM Nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier". Per kete person te shoqerise Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Per pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e dhënë nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontrataindividuale e punës e vlefshme, si dhe te figuroje ne listepagesat per periudhat Janar 2020-shtator2020.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 4 (kater) punonjës të pajisur me certifikatë për dhënie e ndihmës së parë, të siguruar sipas listëpagesës së **paku për 3 muajt e fundit** dhe shoqëruar me kontratë pune dhe certifikatën përkatëse, lëshuar nga organe kompetente publike ose private

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të deshmojë se ka të punësuar në stafin e vetë punonjës me profesionet, të pajisur me deshmë kualifikimi, si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi
- 3 (tre) punonjës elektrikiste
- 3 (tre) punonjës hidraulike
- 2 (dy) punonjës saldatore
- 1 (nje) punonjës elektromekanike
- 2 (dy) punonjës bojaxhi
- 1 (nje) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) hidroizolues
- 2 (dy) punonjës specialist për mirëmbajtjen e sistemeve : Ngrohje - ftohje VRF
- 2 (dy) punonjës montues tubash

Per punonjësit e mesiperm, operatori ekonomik duhet të paraqesë: kartelat personale të sigurimit teknik të lëshuara nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues) në bazë të Ligjit nr.8734 date 01.02.2001 "Per Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve të Instalimeve Elektrike", i ndryshuar dhe të VKM nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi", i ndryshuar. Per punonjësit elektrikiste klasifikimi të jetë minimumu Grupi III, per punonjësit teknik ndertimi duhet të paraqitet dokumenti që verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome). Të gjithë punonjësit e kërkuar me sipër duhet të paraqesë kontratën individuale të punës si dhe të figurojnë në listëpagesat për periudhën Mars 2020 - Shtator 2020, me kohë të plotë pune.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtës minimalisht 10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine	Copë	3	Në pronësi ose me qira
3	Fadroma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Minieskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Gjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Pajisje niveluese (helikopter)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Saldatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Karroca dore	Copë	10	Në pronësi ose me qira
10	Kokore	Copë	40	Në pronësi ose me qira
11	Jelek	Copë	40	Në pronësi ose me qira
12	Tabela	Copë	20	Në pronësi ose me qira

Dokumenta Standarde të Tenderit

13	Ripa sigurimi	Copë	10	Në pronësi ose me qira
14	Depozite uji 5000 l	Copë	2	Në pronësi ose me qira
15	Kompresor	Copë	2	Në pronësi ose me qira
16	Matrapik	Copë	2	Në pronësi ose me qira
17	Betoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qira
18	Skeleri	m2	1500	Në pronësi ose me qira
21	Krik ngrites me goma	Cope	2	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese **Deklaraten e disponueshmërisë së mjeteve dhe pajisjeve teknike**, e shoqeruar me dokumentat e mëposhtme:

- Për pajisjet teknike, te cilat jane ne pronesi te subjektit, duhet të paraqiten kontrata te shitblerjes/faturat tatimore, ndersa kur jane te marra me qera duhet të paraqiten kontrata e qerese (vlefshmeria e se ciles duhet te mbuloje kohezgjatjen e kontrates), fatura tatimore/kontrata shitblerje. Faturat qe nuk jane sipas formatit me siper (per rastet e faturave te biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.
- Për automjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesine e mjetit: çertifikata e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndersa per automjetet e marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese (vlefshmeria e se ciles duhet te mbuloje kohezgjatjen e kontrates).
- Për automjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per automjetet e marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese (vlefshmeria e se ciles duhet te mbuloje kohezgjatjen e kontrates).

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te leshoje nje Deklaratë se makineritë e mësipërme nuk jane të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

***Shenim:** Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar.*

2.3.13 Operatori ekonomik duhet te paraqesë Analize Cmimesh per te gjithë zërat ne preventive qe nuk kane te percaktuar numer analize sipas manualit teknik te cmimeve. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë analize për zërat përkatës të marrë përsipër sipas akt-marreveshjes).

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të respektojnë rigorozisht udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik për operatorët ekonomikë për rastin e bashkimit të operatorëve në procedurat elektronike të prokurimit.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të nënshkruaje dhe vulos specifikimet teknike, grafikun e punimeve, termat e references, etj.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Sic jane ngarkuar ne SPE ne dosjen e prokurimit ne formatin PDF

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Sic jane ngarkuar ne SPE ne dosjen e prokurimit ne formatin PDF

Grafiku i Punimeve:

Sic jane ngarkuar ne SPE ne dosjen e prokurimit ne formatin PDF

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sic jane ngarkuar ne SPE ne dosjen e prokurimit ne formatin PDF

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Sic jane ngarkuar ne SPE ne dosjen e prokurimit ne formatin PDF

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme

Dokumenta Standarde të Tenderit

prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumenta Standarde të Tenderit

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokruues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
